



NDIHMJA JURIDIKE | PRAVNA POMOC
LEGAL AID

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas

**Eulex European Union Rule of Law
Mission**

Drejtoresha Ekzekutive - Zv e Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas Znj. Anita Alaj Kalanderi u takua me Ushtruesin e Detyrës së Shefit të Missionit Z. Cezary Luba.

Me 4 dhjetor Drejtoresha Ekzekutive – Zv e Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas, Znj. Anita Alaj Kalanderi u takua me Ushtruesin e Detyrës së Shefit të Missionit Z. Cezary Luba, për të diskutuar për shërbimet të cilat i ofron Agjencia për Ndhmë Juridike Falas.

Drejtoresha Ekzekutive - Zv e Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas Znj. Anita Alaj Kalanderi informoi se Agjencia për Ndhmë Juridike Falas e themeluar nga Kuvendi i Kosovës, ofron ndihmë juridike falas për ata të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme për t'u siguruar qasje të barabartë në drejtësi, si dhe shprehu interesimin e Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas për të bashkëpunuar me EULEX- in.

Ushtruesi i Detyrës së Shefit të Missionit Z. Cezary Luba theksoi se puna e Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas është shumë e rëndësishme për një sundim efektiv të ligjit në Kosovë. Meqë qasja e barabartë në drejtësi është një prej parimeve themelore të sistemeve demokratike funksionale.

Ai, gjithashtu, bëri të ditur se EULEX- i është i gatshëm që t'i shqyrëtoj mundësitë e Misionit për ta mbështetur Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas.